

VENDIM
Nr.601, datë 28.9.2005

PËR LEJIMIN E DALJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 17 OBJEKTEVE MUZEORE TË FONDIT TË MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR, TIRANË, ME VLERA UNIKALE, TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE, PËR QËLLIME EKSPOZIMI NË VJENË, AUSTRI, MË 30 SHTATOR-15 TETOR 2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 17 objekteve muzeore të fondit të Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë, me vlera unike, të trashëgimisë kulturore kombëtare, për qëllime ekspozimi në Vjenë, Austri, më 25 shtator-15 tetor 2005, sipas listës së vërtetimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për daljen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të këtyre objekteve të zbatohet udhëzimi nr.2, datë 18.3.2004 i Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VËRTETIM

Vërtetojmë se Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë ka depozituar në databazen “Onufri” të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore të dhënat dhe fotot e 17 objekteve, të cilat do të ekspozohen, më datë 6 tetor 2005, në Vjenë të Austrisë me rastin e 600 vjetorit të lindjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Nr.	Kodi	Nr.regj	Titulli i objektit	Pesha	Çmimi
1	12625	1522	Stemë e Principatës së Arbërit	30 kg	50 000 USD
2	12620	1517	Ikonë tre jerarkët shek.XIV	2 kg	30 000 USD
3	12418	1563	Këmbana e Shelcanit e vitit 1455	80 kg	50 000 USD
4	12619	1516	Ikonë e Shëngjergjit shek.XV	1.8 kg	30 000 USD
5	25702	1718	Hyrja e Shën Mërisë në tempull	1.9 kg	70 000 USD
6	25716	100	Historia e Skënderbeut M.Barleti	1 kg	5 000 USD
7	25717	101	Libër për Skënderbeun Bot.1529	1 kg	3 000 USD
8	25718	104	Fjalor latinisht-shqip F.Bardhi	810 gr	2 500 USD
9	25715	288	La spada D’Orione”	620 gr	1 700 USD
10	25695	2776	Qendisje Skënderbeu Q.Shtiza	160 gr	5 000 USD
11	13504	2866	Basoreliev në bronx Skënderbeu	700 gr	2 000 USD
12	34766	3641	Afresku Gjon Pagëzori shek.XIII	7.5 kg	70 000 USD
13	34644	2957	Tablo e qindis.fig.kalorësi suliot	1 kg	3 000 USD
14	12758	1678	Shpatë me këllëf argjenti 130 x 4.7 cm	3 kg	2 500 USD
15	12755	1676	Kobure e traditës shqiptare 59.5 cm	1.3 kg	1 300 USD
16	12754	1675	Kobure e traditës shqiptare 38.7 cm	1 kg	1 500 USD
17	34777	1	Shpatë e S.Bajazitit II 127 cm shekulli XV mbishkrim autentik		10 000 USD

Shënim: Lista mbyllet me nr.17